



REPUBLIKA E KOSOVËS  
 REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
 KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
 NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
 INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Me të cilin vërtetoj se nga Zyra e Komisionit të Pavarur për Media kam pranuar shkresën:

With this I confirm receipt the official document from the Office of Independent Media Commission:

**Emri dhe numri i referencës:**  
**Name and reference number:**  
**Ime i broj referencije**

**IPKO TELECOMMUNICATIONS L.L.C**  
**Robert ERZIN**  
**Prishtinë**

**data 10.01.2017**  
**date:**  
**datum**

**Prishtinë**  
**Ref: 1612/1356/LEG/hzg**

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
 NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
 INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



*ESAO*

*IPKO*

*[Signature]*

Emri i përfaqësuesit të KPM  
 Name of IMC representative

Rr. Perandori Justinian Nr.124  
 10000 Prishtinë KOSOVË  
 Tel. 038 245-031 : Fax.038 245-034

Nënshkrimi i përfaqësuesit të KPM  
 Signature of IMC representative

*[Signature]*

\_\_\_\_\_

Emri i pranuesit dhe data  
 Name of Recipient and date


Nënshkrimi i pranuesit data dhe ora  
 Signature of Recipient date and time

Vendi/Place

Data dhe ora /Date and time:

*Prishtinë / IPKO-se*

*10/01/2017*



IPKO TELECOMMUNICATIONS L.L.C  
Robert ERZIN  
Drejtor Ekzekutiv  
Prishtinë

Ankesa Nr. 2016/253  
Ref:1612/1356/KPM/am

### VENDIM

Lidhur me Ankesën Nr. 2016/253 - IPKO (Palë Ankuese) kundër operatorëve kabllorë: NEGE NET, ELEKTRA, ASTRA NET, KADRIA NET, J&B NET, BRUTI (*EAGLE*) dhe GALAKTIKA

---

### Faktet

1. KPM, me datën 26 tetor 2016 ka pranuar një ankesë të parashtruar nga IPKO (Palë Ankuese) ndaj 32 operatorëve të shpërndarjes, ku përfshihen operatorë kabllorë, IPTV, ofrues të shërbimeve të internetit dhe operatorë të shpërndarjes të palicencuar, për të cilët IPKO pretendon se janë duke transmetuar përmbajtje programore të platformës "Digitalb".
2. Pala ankuese në kuadër të ankesës së datës 26 tetor 2016, ka përfshirë çështje të ndryshme për sa i përket operatorëve të shpërndarjes.
3. KPM, përmes këtij vendimi do t'i shqyrtojë vetëm ankesat që kanë të bëjnë me bartjen e kanaleve të "Digitalb" të parashtruara ndaj operatorëve kabllorë të licencuar në KPM siç janë: NEGE NET, ELEKTRA, ASTRA NET, KADRIA NET, J&B NET, BRUTI (*EAGLE*) dhe GALAKTIKA. Për çështjet tjera të përmendura në ankesën e palës ankuese, janë duke u zhvilluar procedura të veçanta ligjore.
4. KPM, me qëllim të vlerësimit të pretendimeve ankimore të Palës Ankuese, ka realizuar vizita në terren për të verifikuar pajtueshmërinë e operatorëve kabllor me obligimet nga e drejta e transmetimit. KPM, nga monitorimi në terren ka gjetur se operatorët kabllorë, ndaj të cilëve është parashtruar ankesa, nuk janë duke transmetuar kanale të platformës "Digitalb", duke vepruar kështu në pajtim me Rregulloren KPM-2016/01.

### Analiza Ligjore

5. Komisioni, bazuar në faktet e lartpërmendura konkludon se operatorët kabllorë, ndaj të cilëve është parashtruar ankesë nga ana e Palës Ankuese, nuk janë gjetur në shkelje të Rregullores

KPM-2016/01, pasi që nuk janë duke transmetuar kanale të platformës “Digitalb”, ashtu siç pretendohet në ankesën e Palës Ankuese.

6. KPM, pretendimin e Palës Ankuese e ka trajtuar në kuptimin e nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01, i cili përcakton se:

*“I licencuari obligohet të bëjë shpërndarjen e ofruesve të shërbimit medial bazuar vetëm në marrëveshjet valide për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audio-vizuale”.*

7. Komisioni i KPM-së, bazuar në të gjeturat e monitorimit ka konstatuar se operatorët kabllorë, në kuadër të listës së tyre të kanaleve, kanë të përfshirë kanale për të cilat kanë dëshmuar se posedojnë marrëveshje valide për sa i përket të drejtës së transmetimit.

#### Vendimi


8. Komisioni, bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura Vendosi që ankesa e Palës Ankuese, përmes së cilës pretendohet se operatorët kabllorë janë duke bërë transmetim ilegal të përmbajtjeve programore, përkatësisht të kanaleve të platformës “Digitalb”, të refuzohet si e pabazuar.

#### E drejta për Ankesë

9. Ankesat i parashirohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
10. Bordi për Ankesa do t’i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërishit relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

#### Lëshimi i Vendimit

Komisioni e lëshon këtë vendim



Adnan MEROVCI  
Kryetar  
Komisioni i Pavarur i Mediave



28.12.2016

datë